



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Tregtisë dhe Industrisë**  
**Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and industry**

|                                                                                                       |            |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA                                               |            |
| QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA                                               |            |
| MINISTRIA E TREGTISE DHE INDUSTRIJE-MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE-MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY |            |
| Nr. Org.<br>Org. Jendraci<br>Org. Unit                                                                | 03/PER     |
| Nr. Prot.<br>Broj Prot.<br>Prot. No.                                                                  | 1523       |
| Nr. / faqes<br>Broj stranica<br>No. pages                                                             | 02         |
| Data<br>Datum<br>Date                                                                                 | 03.10.2016 |
| Prishtinë / a                                                                                         |            |

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligji Nr. 03/ L -149, neni 12, paragrafi 4, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë bën :

## **RISHPALLJE E KONKURSIT**

Lloji i kontratës “Marrëveshje për shërbime të veçanta”

**Institucioni:** Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
**Departamenti:** Industrisë  
**Titulli i vendit të punës:** Ekspert për hartimin e rregullave teknike

**Numri i ekspertëve që do të pranohen:** 1

**Vendi i punës:** Prishtinë

**Datë:** 03.10.2016

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Udhëheqë dhe harton draft-ligje dhe draft-rregullore të tjera nga fushë veprimtaria e kërkesave teknike dhe vlerësimi i përshtatshmërisë së produkteve;
- Koordinon aktivitetin e transpozimit të direktivave evropiane;
- Prioritizon transpozimin dhe implementimin e direktivave me komponentët tjera të infrastrukturës së cilësisë;
- Asiston në organizimin fushata informative-promovuese, në funksion të forcimit të kuadrit ligjor teknik si dhe të senzibilizimit të partnerëve industrial për aplikimin e standardeve teknike dhe certifikimin e produkteve industriale etj.;
- Propozon veprime dhe masa për ngritjen dhe funksionalizimin e procedurave për vlerësimin e konformitetit;
- Sipas kërkesës së epriorit kryen edhe detyra të tjera shtesë.

**Kualifikimet për këtë vend të punës:**

- Diplomë universitare: Fakulteti Teknik, Ekonomik ose Shkenca Natyrore.
- Tri (3) vjet përvojë pune;
- Njohje e MS Office dhe internetit
- Prioritet njohja e gjuhës angleze
- Aftësi për punë nën presion dhe fleksibilitet në punë

**Kohëzgjatja dhe pagesa:**

- Kohëzgjatja e kontratës 3 + 3 muaj.
- Paga bruto 500.00 Euro / në muaj.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

**Procedurat e konkurrimit:**

Konkurrimi është i hapur për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të interesuar.

**Data e mbylljes së konkursit:**

09.10.2016

**Paraqitja e kërkesave**

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga *web* faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit , në adresën [www.mti-ks.org](http://www.mti-ks.org) dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, Adresa : Rr. "Muharrem Fejza " p. n. 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 8:00 - 16:00 deri më: **09.10.2016**. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.